



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 55

Prishtinë, më 19. 04. 2010, në orën 12:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Petar Miletij.

Mungoi: Naser Rugova.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues të OSBE-së, të KDI-së dhe Besart Mustafa – praktikant.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Paraqitja e punës gjashtëmuajore të ekspertit Kaloyan Simeonov,**
- 3. Shqyrtimi i Udhëzuesit për elaborimin dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vjetor të veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Paraqitja e punës gjashtëmujore të ekspertit Kaloyan Simeonovo

Kryesuesja - I njoftoi se eksperti Kaloyan Simeonovo e ka përfunduar misionin gjashtëmujor në mbështetje të Komisionit për Integritet Evropian. E luti ekspertin ta paraqesë një raport lidhur me punën e tij gjatë këtij intervali kohor.

Kaloyan Simeonovo - I paraqiti aktivitetet e tij për periudhën gjashtëmujore. Theksoi se kjo është hera e parë që TAIEK-i e ka realizuar asistencën afatmesme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Është shumë pozitive që kjo asistencë është realizuar në Komisionin për Integritet Evropian. I paraqiti aktivitetet e tij për periudhën tetor 2009 - prill 2010, në të cilin përfshiheshin: Konsultimi i Komisionit për Integritet Evropian në lidhje me procesin e afrimit të *Acquis communautaire*, përditësimi i doracakut për përafrimin e legjislativës së Kosovës me *Acquis communautaire* të BE-së dhe pjesëmarrja në hartimin dhe në konsultimin e Planit të veprimit për integritet evropian të Kuvendit për vitin 2010. Plani i Veprimit i pasqyron rekomandimet e Komisionit Evropian 2009 të dala nga Raporti i Progresit. Si aktivitete të tjera i paraqiti edhe propozimin për Udhëzimet e përpunimit dhe monitorimin e zbatimit të Planit vijtor të Kuvendit për integritet evropian, ndryshimet në mandatin e Komisionit, të cilat janë miratuar, propozimin për ndryshime në Rregulloren e punës të Kuvendit të Kosovës në lidhje me procesin e integritetit evropian, shqyrtimin e Planit të punës të Komisionit për 2010, propozimin për Memorandumin e mirëkuptimit të Komisionit për Integritet Evropian dhe të Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim të Integriteteve Evropiane, si dhe përgatitja dhe konsultimi i një propozimi për Projektin IPA-së 2010 për Kuvendin e Kosovës. Ndër aktivitetet e tij, gjatë kësaj periudhe, e theksoi edhe sigurimin e trajnimit të administratës së Kuvendit për procedurën e harmonizimit të legjislativës.

Njomza Emini - E falënderoi ekspertin për angazhimin e tij për ta ndihmuar Komisionin. E falënderoi edhe për angazhimin për organizimin e udhëtimit zyrtar për në Bullgari. Kërkoj nga eksperti të paraqesë raport me shkrim për punën dhe për angazhimin e tij për Komisionin.

Kaloyan Simeonovo - Jam duke e përgatitur raportin. Në fund të javës do t'ju dërgoj. Do ta përgatis edhe një *fajll* elektronik me të gjitha materialet, të cilat i kam hartuar në këtë gjashtëmujor.

Kryesuesja – E falënderoi Komisionin Evropian për mbështetjen e vazhdueshme që po ia jep Komisionit për Integritet Evropian në zhvillimin e demokracisë parlamentare.

3. Shqyrtimi i Udhëzuesit për elaborimin dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vijtor të veprimit të Kuvendit për integritet evropian

Kryesuesja - E kemi për shqyrtim Udhëzuesin, i cili po ashtu është përgatitur nga eksperti Simeonovo. Shtoi se Raporti i Progresit publikohet në nëntor, mirëpo hartimi i tij fillon në muajin qershor. Është shumë e rëndësishme të përmbushen sfidat, të cilat janë identifikuar në këtë Plan. Lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të veprimit njoftoi se ka kërkuar nga Kryetari i Kuvendit ta marrë përsipër udhëheqjen e Planit të veprimit, si shkallë më e lartë në Kuvendin e Kosovës. Njoftoi se sot, në mbledhjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve, është miratuar Udhëzuesi për elaborimin dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vijtor të veprimit të Kuvendit për integritet evropian. Po ashtu, tash e tutje, kryetarët e komisioneve do t'u raportojnë me shkrim Kryetarit të Kuvendit, Kryesisë dhe Komisionit për Integritet Evropian lidhur me përmbushjen e

sfidave të identifikuara në Raportin e Progresit. Komisioni do të përpiqet të raportojë në seancë plenare, së paku dy herë në vit. Sa i përket Komisionit për Integritet Evropian, e ka filluar menjëherë zbatimin e tij. Në çdo takim janë ftuar ministrat të raportojnë për të arriturat në këtë drejtim. Njoftoi se ditën e enjte do të organizohet një dëgjim publik me ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe me ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, për rikapitulimin e punës së kryer.

Nait Hasani - Kërkoi të organizohet një takim i Komisionit me kryetarët e komisioneve parlamentare, që të harmonizohet puna e komisioneve. Kërkoi të organizohet edhe një takim me Kryetarin e Kuvendit, që të shihet mundësia më e mirë e bashkërendimit dhe e zbatimit të aktiviteteve.

Kryesuesja - U pajtua me propozimin e deputetit Hasani. Shtoi se me këtë Udhëzues është paraparë të zhvillohet një takim i përbashkët me Kryetarin e Kuvendit dhe me kryetarët e komisioneve parlamentare. Të njëjtin propozim e kam paraqitur edhe sot në takimin që kishim me Kryetarin e Kuvendit. Tani koordinimi i Planit të veprimit do të bëhet nga Kryetari i Kuvendit, që të mos ketë ngurrim nga kryetarët e Komisioneve, siç ka ndodhur më herët.

Fatmir Rexhepi – E falënderoj ekspertin për asistencën që ia ka dhënë Komisionit. Udhëzuesi është një draft, i cili do të ndihmojë në punën e mëtutjeshme për përmbushjen e sfidave që dalin nga Raporti i Progresit. Me të do të harmonizohet puna e komisioneve. Parësore në këtë dokument është vendosja e aktiviteteve, të cilat duhet të ndërmerren.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Miratohet Udhëzuesi për elaborimin dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit vjetor të veprimit të Kuvendit për integritet evropian.

4. Të ndryshme

a) Vizita në Bullgari

Njomza Emini - Kërkoi ta kenë agjendën për vizitën që do të realizohet me 26 dhe 27 prill 2010 në Bullgari.

Kryesuesja - Njoftoi se ka diskutuar me organizatorin - ekspertin Simeonov dhe se brenda dy ditëve do t'i marrin të gjitha materialet e nevojshme për këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi